



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 34

Tiranë – E martë, 19 mars 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 41/2019, datë 13.3.2019	Për zgjedhjen e një anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare..... 1481
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 38, datë 7.3.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Kastrati energy” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike..... 1481
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 39, datë 7.3.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Kastrati energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike..... 1482
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 40, datë 7.3.2019	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e “Udhëzuesit për monitorimin e tregut të energjisë elektrike” 1483
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 41, datë 11.3.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Berat, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë..... 1483
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 42, datë 11.3.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Lezhë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë..... 1486
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 43, datë 11.3.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Durrës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë..... 1488
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 44, datë 11.3.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Gjirokastrë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë..... 1490

Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 45, datë 11.3.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të partisë demokratike, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	1492
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 61, datë 12.3.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të partisë demokratike, qarku Kukës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	1494
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 62, datë 12.3.2019	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Korçë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	1496
	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për shpalljen të zhdukur të shtetasit Vahit Bardhi.....	1498
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetases Edlira Kovaçi.....	1498



VENDIM
Nr. 41/2019

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 114, pika 3, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Znj. Xhoana Lilaj zgjidhet anëtare e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 13.3.2019

VENDIM
Nr. 38, datë 7.3.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“KASTRATI ENERGY” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miraturar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miraturar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përparitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k.,

për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Kastrati Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 111 prot., datë 1.2.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 22, datë 19.2.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Pas kësaj vendimmarrje, ERE, me shkresën nr. 32/5 prot., datë 18.2.2019, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe, pas përfundimit të afatit, rezultoi se nuk ka pasur palë të interesuara.

- ERE, me shkresën nr. 111/1 prot., datë 19.2.2019, dërgoi pranë subjektit njoftimin e vendimit, si dhe e bëri me dije për mungesën e dokumentacionit të konstatuar në aplikim.

- Shoqëria “Kastrati Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 111/2, datë 20.2.2019, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar.

- Aplikimi i shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germa “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Kastrati Energy” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).



2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi**

**VENDIM
Nr. 39, datë 7.3.2019**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“KASTRATI ENERGY” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “ç” dhe nenit 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “d”; nenit 5, pika 1, germa “d”, nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Kastrati Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 111 prot., datë 1.2.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 21, datë 19.2.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Pas kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 32/5 prot., datë 18.2.2019, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe mbas përfundimit të afatit,

rezultoi se nuk ka pasur komente nga palë të interesuara.

- ERE, me shkresën nr. 111/1 prot., datë 19.2.2019, dërgoi pranë subjektit njoftimin e vendimit, si dhe bëri me dije për mungesën e dokumentacionit të konstatuar në aplikim.

- Shoqëria “Kastrati Energy” sh.p.k., me shkresën nr. 111/2, datë 20.2.2019, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar.

- Aplikimi i shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”, pika 4.7.1, germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Kastrati Energy” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi**

**VENDIM****Nr. 40, datë 7.3.2019**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
MIRATIMIN E “UDHËZUESIT PËR
MONITORIMIN E TREGUT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16, 22, 51 dhe 97, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbi fillimin e procedurave për miratimin e “Udhëzuesit për monitorimin e tregut të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Gjatë vitit 2018 me asistencën dhe konsulencën e USAID/RTI, është punuar dhe hartuar udhëzuesi për monitorimin e tregut të energjisë elektrike, në mbështetje të detyrimeve të ERE-s për monitorimin e tregut të energjisë, që lindin nga ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë”, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera për këtë qëllim.

- Ky udhëzues është i organizuar në kapituj dhe seksione që përshkruajnë:

1. Një vështrim të përgjithshëm për vendosjen e funksioneve të monitorimit të tregut nga ERE dhe hapat e nevojshëm për t’u ndërmarrë në procesin e zhvillimit të funksioneve të monitorimit të tregut.

2. Rolet e pjesëmarrësve të tregut me qëllim monitorimin e tregut, të caktuara nga ERE sipas legjislacionit përkatës në Shqipëri, ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Rregullat e Tregut, si dhe legjislacioni në rajon në kontekstin e kërkesave dhe pranimeve të Bashkimit Evropian (BE).

3. Parimet që duhet të përshtaten për monitorimin e tregut.

4. Udhëzime për zbatimin e përgjegjësive të monitorimit të tregut, të tilla si mjetet për identifikimin e sjelljeve që nuk janë në përputhje me parimet e konkurrencës dhe identifikimin e manipulimeve të çmimeve.

5. Aspektet e zbatimit në lidhje me monitorimit të tregut, përfshirë proceset e nevojshme për t’u zbatuar, kërkesat rregullatore të vendosura mbi pjesëmarrësit e tregut, organizimi i brendshëm dhe strukturimi i funksionit të monitorimit të tregut brenda ERE-s dhe rregullat për zbatimin e kërkesave.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e “Udhëzuesit për monitorimin e tregut të energjisë elektrike”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesit, Autoritetin e Konkurrencës, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, në lidhje me këtë vendimarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi**

VENDIM**Nr. 41, datë 11.3.2019**

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË
SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË PARTISË
DEMOKRATIKE, QARKU BERAT, PËR
PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË
NJOFTUAR NGA KUVENDI
I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 11.3.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri	kryetar;
Denar Biba	zv.kryetar;
Bledar Skënderi	anëtar;
Edlira Jorgaqi	anëtare;
Rezarta Bitri	anëtare;

shqyrtoi çështjen me:



OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Berat, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Astrit Veliaj.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, neni 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 746/2 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj njofton krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit z. Astrit Ferik Veliaj, deputet i zonës zgjedhore, qarku Berat.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Demokratike për zonën zgjedhore qarku Berat, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 qershor 2017, ka fituar 1 (një) mandat dhe kandidati fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Berat, është numri rendor 1 (një) z. Eduard Ismail Halimi.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i

Faqe | 1484

deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Eduard Ismail Halimi, deputet i zonës zgjedhore qarku Berat, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 10, datë 19.2.2018, i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë z. Astrit Ferik Veliaj.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Berat, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur një në tre emrat e parë kandidat nga secila gjini, si dhe duke mos pasur tridhjetë për qind të listës shumemërore nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017, vendosi sanksionin administrativ gjorbë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë) milionë lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore qarku Berat duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, me vendimin nr. 338, datë 30.5.2017, “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2017”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Demokratike për 12 zonat zgjedhore, së bashku me *deklaratat model 03*, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas *deklaratës model 03*, rezulton se gjinia femërore, si gjinia më pak e përfaqësuar në listën shumemërore qarku Berat pas dorëheqjes së znj. Juvina Fejzi Jani dhe znj. Monika Asqeri Qosja ka shteruar. Në mbështetje të nenit 164, pika 2 (fjalë e fundit), duke qenë se lista e gjinisë femërore ka shteruar, KQZ-ja nuk mund të zbatojë sanksionin plotësues për shkak të ezaurimit të procedurës administrative për vendimin nr. 10, datë 19.2.2018, mbi dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë z. Astrit Ferik Veliaj.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit vijues të listës shumemërore të Partisë Demokratike, të zonës zgjedhore qarku Berat, të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati për deputet me numër rendor 3 (tre), z. Lefter Novruz Maliqi.



Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Z. Lefter Novruz Maliqi, referuar ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 4.3.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2109.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Lefter Novruz Maliqi, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Z. Lefter Novruz Maliqi më datë 27.5.2017 ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit me numër unik PD-03-BR si kandidat i listës shumemërore të subjektit politik Partia Demokratike për zgjedhjet e datës 25.6.2017 për Kuvendin e Shqipërisë. Me shkresën nr. 3537 prot., datë 30.5.2017, është kërkuar informacion pranë zyrës së Gjendjes Gjyqësore dhe me shkresën nr. 3540 prot., datë 30.5.2017, në lidhje me kandidatët e listës shumemërore të subjektit politik Partia Demokratike. Me shkresën nr. 3537/1 prot., datë 1.6.2017 prot., të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve rezulton se z. Lefter Novruz Maliqi është i padënuar nga gjykatat shqiptare. Me shkresën nr. 3540/1 prot. datë 6.7.2017, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, mbi verifikimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputetë të subjektit politik Partia Demokratike, njofton se subjekti ka këto ndryshime në gjenealitetet e mëparshme, të padeklaruara në formularët e vetëdeklarimit:

Mbiemrin e ka ndryshuar nga “Brisku” në “Maliqi” dhe datëlindja nga “10.9.1972” bëhet në “10.2.1972”.

Të dhënat e evidentuara në të dy formularët e vetëdeklarimit janë të njëjta dhe nuk kanë ndryshime. KQZ-ja, me vendimin nr. 338, datë 30.5.2017, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Demokratike për zgjedhjet për Kuvendin e datës 25.6.2017, ku rezulton se: z. Lefter

Novruz Maliqi, është kandidat i kësaj liste me numrin rendor numër 3 (tre) qarku Berat.

Me shkresën nr. 1353 prot., datë 7.3.2019 z. Lefter Maliqi ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit të korrigjuar shoqëruar me një sqarim ku ka deklaruar se nuk ka pasur dëni për ndryshimet e bëra nga prindërit e tij në kohën kur ka qenë i mitur.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1027 prot., datë 4.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 1026 prot., datë 4.3.2019, dhe nr. 1298 prot., datë 5.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Berat, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Lefter Novruz Maliqi.

KQZ-ja, gjithashtu, ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresat nr. V-679/1 prot., datë 4.3.2019 dhe nr. V-692/1 prot., datë 7.3.2019, zyra e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Berat, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Lefter Novruz Maliqi, me gjenealitetet e deklaruara dhe ato të ndryshuara, sipas të cilave rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Lefter Novruz Maliqi, rezulton se nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit vijues i listës shumemërore të Partisë Demokratike në zonën zgjedhore qarku Berat, i renditur me numër rendor 3 (tre), z. Lefter Novruz Maliqi.



PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2 dhe nenin 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Berat, z. Lefter Novruz Maliqi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETARI

Klement Zguri

VENDIM

Nr. 42, datë 11.3.2019

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË
SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA
SOCIALISTE PËR INTEGRIM, QARKU
LEZHË, PËR PLOTËSIMIN E
VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA
KUVENDI I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 11.3.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri	kryetar;
Denar Biba	zv.kryetar;
Bledar Skënderi	anëtar;
Edlira Jorgaqi	anëtare;
Rezarta Bitri	anëtare;

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Lezhë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Viktor Tushaj.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Faqe|1486

BAZA LIGJORE: neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 764/2 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit z. Genci Gjonçaj njofton krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit z. Viktor Mark Tushaj, deputet i zonës zgjedhore qarku Lezhë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Lëvizja Socialiste për Integrim për zonën zgjedhore qarku Lezhë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 qershor 2017, ka fituar 1 (një) mandat dhe kandidati fitues nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Lezhë, është numri rendor 1 (një) z. Viktor Mark Tushaj.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Lezhë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës.

Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit



67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, fjalia e dytë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit vijues të listës së Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në zonën zgjedhore qarku Lezhë.

Në bazë të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Lezhë, të cilit i kalon mandati i deputetit, është numri rendor 2 (dy) z. Gjovalin Pjetër Kadeli.

Duke qenë se kandidati me nr. rendor 2 (dy) i ndjeri z. Gjovalin Kadeli ka ndërruar jetë, kandidati vijues, të cilit i kalon mandati i deputetit, është numri rendor 3 (tre) znj. Elda Artan Hoti.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 605 prot., datë 27.2.2019, znj. Elda Artan Hoti është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me shkresën nr. 605/1 prot., datë 1.3.2019, është depozituar deklaratë dorëheqjeje e kandidates së listës shumemërore znj. Elda Artan Hoti.

Pavarësisht depozitimit të deklaratës së dorëheqjes, njëkohësisht znj. Elda Artan Hoti, referuar ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 5.3.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2113, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të znj. Elda Artan Hoti, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa

sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime apo ndryshime në gjenealitete.

Znj. Elda Artan Hoti më datë 28.4.2017 ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit me numër unik LSI-03-LE si kandidate e listës shumemërore të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim për zgjedhjet e datës 25.6.2017 për Kuvendin e Shqipërisë. Me shkresën nr. 2432 prot., datë 30.4.2017, është kërkuar informacion pranë zyrës së Gjendjes Gjyqësore dhe me shkresën nr. 2450 prot., datë 1.5.2017, është kërkuar informacion pranë zyrës së Gjendjes Civile në lidhje me kandidatët e listës shumemërore të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim. Me shkresën nr. 2432/1 prot., datë 2.5.2017 prot., të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve rezulton se znj. Elda Artan Hoti është e padënuar nga gjykatat shqiptare. Me shkresën nr. 62/1 prot., datë 25.1.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, mbi verifikimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputetë të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, njofton se subjekti ka këto ndryshime në gjenealitetet e mëparshme, të padeklaruara në formularët e vetëdeklarimit:

Ka ndryshuar emrin e babait nga David në Artan.

KQZ-ja, me vendimin nr. 288, datë 5.5.2017 ka miratuar listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.6.2017, ku rezulton se: znj. Elda Artan Hoti është kandidate e kësaj liste me numrin rendor numër 3 (tre) qarku Lezhë.

Të dhënat e evidentuara në të dy formularët e vetëdeklarimit janë të njëjta dhe nuk kanë ndryshime. Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1299 prot., datë 5.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 1298 prot., datë 5.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Lezhë, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Elda Artan Hoti, që



ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-692/1 prot., datë 7.3.2019, zyra e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Lezhë, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Elda Artan Hoti, me gjenealitetet e deklaruara dhe ato të ndryshuara, sipas së cilës rezulton se është e padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të znj. Elda Artan Hoti, rezulton se nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në zonën zgjedhore qarku Lezhë, i renditur me numër rendor 3 (tre), znj. Elda Artan Hoti.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Lezhë, znj. Elda Artan Hoti.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETARI
Klement Zguri

VENDIM

Nr. 43, datë 11.3.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM, QARKU DURRËS, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 11.3.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri	kryetar;
Denar Biba	zv.kryetar;
Bledar Skënderi	anëtar;
Edlira Jorgaqi	anëtare;
Rezarta Bitri	anëtare;

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënie e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Durrës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, znj. Nora Malaj.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008. “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 759/2 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit z. Genci Gjonçaj njofton krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit znj. Nora Dod Malaj, deputet i zonës zgjedhore qarku Durrës.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i



Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Lëvizja Socialiste për Integrim për zonën zgjedhore qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 2 (dy) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Durrës, është numri rendor 1 (një) z. Lefter Haki Koka dhe numri rendor 2 (dy) znj. Nora Dod Malaj.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Durrës, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin e parë në listë të gjinisë përkatëse.

Gjithashtu, konstatojmë se vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, fjalë e dytë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit të parë të gjinisë përkatëse të listës së Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në Zonën Zgjedhore qarku Durrës.

Në bazë të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati i parë i secilës gjini nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017 qarku Durrës, të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati për deputet me numër rendor 6 (gjashtë) znj. Edlira Adem Hyseni.

Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i

takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 604 prot., datë 27.2.2019, znj. Edlira Adem Hyseni është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Znj. Edlira Adem Hyseni, referuar ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 5.3.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2114.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të znj. Edlira Adem Hyseni, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime. Në seksionin “I. B” të formularit të vetëdeklarimit, gjenealitete të mëparshme, ka deklaruar ndryshime në mbiemrin: Dule.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1299 prot., datë 5.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 1298 prot., datë 5.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Durrës, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Edlira Adem Hyseni, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. V-692/1 prot., datë 7.3.2019 zyra e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Durrës, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Edlira Adem Hyseni, sipas së cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.



Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të znj. Edlira Adem Hyseni, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Rezulton se me vendimin nr. 959, datë 23.7.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, znj. Edlira Adem Hyseni është regjistruar si kandidate e subjektit politik Lëvizja Socialiste e Shqipërisë, për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, qarku Durrës, Bashkia Durrës. Aktualisht ajo është anëtare e Këshillit të Bashkisë Durrës. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar vendimi i Këshillit Bashkiak Durrës nr. 587, datë 7.3.2019, për miratimin e dorëheqjes nga funksioni i anëtarit të Këshillit Bashkiak Durrës të znj. Edlira Adem Hyseni, dhe shpalljen e vakancës në Këshillin Bashkiak.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të parë i gjinisë përkatëse në listën shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në zonën zgjedhore qarku Durrës, i renditur me numër rendor 6 (gjashtë), znj. Edlira Adem Hyseni.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Durrës, znj. Edlira Adem Hyseni.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETARI
Klement Zguri

VENDIM

Nr. 44, datë 11.3.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM, QARKU GJIROKASTËR, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 11.3.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri	kryetar;
Denar Biba	zv.kryetar;
Bledar Skënderi	anëtar;
Edlira Jorgaqi	anëtare;
Rezarta Bitri	anëtare;

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Gjirokastrë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Vangjel Tavo.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 753/2 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit z. Genci Gjoncaj njofton krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit z. Vangjel Llambi Tavo, deputet i zonës zgjedhore, qarku Gjirokastrë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i



Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Lëvizja Socialiste për Integrim për zonën zgjedhore qarku Gjirokastrë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 1 (një) mandat dhe kandidati fitues nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Gjirokastrë, është numri rendor 1 (një) z. Vangjel Llambi Tavo.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Gjirokastrë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës.

Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, fjalia e dytë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit vijues të listës së Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në zonën zgjedhore qarku Gjirokastrë.

Në bazë të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Gjirokastrë, të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati për deputet me numër rendor 2 (dy), znj. Ediola Përparim Braha.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i

takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 603 prot., datë 27.2.2019, znj. Ediola Përparim Braha është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me shkresën nr. 603/1 prot., datë 1.3.2019 është depozituar deklarata e dorëheqjes e kandidates së listës shumemërore znj. Ediola Përparim Braha.

Pavarësisht depozitimit të deklaratës së dorëheqjes, njëkohësisht znj. Ediola Përparim Braha, referuar ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 4.3.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2111, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të znj. Ediola Përparim Braha, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime. Në seksionin I.B të formularit të vetëdeklarimit, gjenealitete të mëparshme, ka deklaruar mbiemrin: Pashaj.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1299 prot., datë 5.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 1298 prot., datë 5.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Gjirokastrë, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Ediola Përparim Braha, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. V-692/1 prot., datë 7.3.2019 zyra e Gjendjes Gjyqësore ka



dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Gjirokastrë, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Ediola Përparim Braha, sipas së cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare. Duke qenë se nuk rezulton asnjë e dhënë që znj. Ediola Përparim Braha nuk përfshihet në kushtet e ndalimeve për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të znj. Ediola Përparim Braha, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Rezulton se me vendimin nr. 913, datë 13.7.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, znj. Ediola Përparim Braha është reregjistruar si kandidate e subjektit politik Lëvizja Socialiste e Shqipërisë, për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, qarku Gjirokastrë, Bashkia Tepelenë. Aktualisht ajo është anëtare e Këshillit të Bashkisë Tepelenë. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar vendimi nr. 19, datë 8.3.2019 i Këshillit Bashkiak Tepelenë për miratimin e dorëheqjes nga funksioni i anëtarit të Këshillit Bashkiak Tepelenë të znj. Ediola Përparim Braha.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integritet në zonën zgjedhore qarku Gjirokastrë, i renditur me numër rendor 2 (dy), znj. Ediola Përparim Braha.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integritet, qarku Gjirokastrë, znj. Ediola Përparim Braha.

Faqe | 1492

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETARI
Klement Zguri

VENDIM Nr. 45, datë 11.3.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE, QARKU TIRANË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 11.3.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri	kryetar;
Denar Biba	zv.kryetar;
Bledar Skënderi	anëtar;
Edlira Jorgaqi	anëtare;
Rezarta Bitri	anëtare;

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënie e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Lulzim Basha.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, neni 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 739/2 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit z. Genci Gjoncaj njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të



parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Tiranë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Demokratike për zonën zgjedhore qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 11 (njëmbëdhjetë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Tiranë, janë numri rendor 1 (një) z. Lulzim Xhelal Basha, me numër rendor 2 (dy) znj. Orjola Hysni Pampuri, me numër rendor 3 (tre) znj. Rudina Azem Hajdari, me numër rendor 4 (katër) znj. Grida Agim Duma, me numër rendor 5 (pesë) znj. Albana Sadik Vokshi, me numër rendor 6 (gjashtë) znj. Jorida Hasan Tabaku, me numër rendor 7 (shtatë) z. Sali Ram Berisha, me numër rendor 8 (tetë) z. Halim Marsut Kosova, me numër rendor 9 (nëntë) z. Gent Hysen Strazimiri, me numër rendor 10 (dhjetë) z. Fatmir Ali Mediu, me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë) z. Dashamir Hamit Shehu.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Tiranë, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur tridhjetë për qind të listës shumemërore nga secila gjini. KQZ-ja me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017 vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë) milionë lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore qarku

Tiranë duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumemërore e Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Tiranë, të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati për deputet me numër rendor 47 (dyzet e shtatë), znj. Majlinda Skënder Halilaj.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 569 prot., datë 27.2.2019, znj. Majlinda Halilaj është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Znj. Majlinda Halilaj, referuar ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 4.3.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2110, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të znj. Majlinda Skënder Halilaj, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1299 prot., datë 5.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe me



shkresën nr. 1298 prot., datë 5.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Majlinda Skënder Halilaj. KQZ-ja, gjithashtu ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. V-692/1 prot., datë 7.3.2019 zyra e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, znj. Majlinda Skënder Halilaj, sipas së cilës rezultoi se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të znj. Majlinda Skënder Halilaj, rezultoi se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumemërore e Partisë Demokratike në zonën zgjedhore qarku Tiranë, i renditur me numër rendor 47 (dyzet e shtatë), znj. Majlinda Skënder Halilaj.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, nenin 175 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, znj. Majlinda Skënder Halilaj.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETARI
Klement Zguri

VENDIM Nr. 61, datë 12.3.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE, QARKU KUKËS, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 12.3.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri	kryetar;
Denar Biba	zv.kryetar;
Bledar Skënderi	anëtar;
Edlira Jorgaqi	anëtare;
Rezarta Bitri	anëtare;

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Kukës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Flamur Dalif Noka.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit z. Genci Gjonçaj njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetëve të zonës zgjedhore, qarku Kukës, të subjektit politik Partia Demokratike.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit,



kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Demokratike, për zonën zgjedhore qarku Kukës, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 2 (dy) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Kukës, është numri rendor 1 (një) z. Flamur Dalif Noka dhe numri rendor 2 (dy) z. Isuf Zenel Çela.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Kukës, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur tridhjetë për qind të listës shumemërore nga secila gjini. KQZ-ja me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017 vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë) milionë lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore qarku Kukës, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, me vendimin nr. 338, datë 30.5.2017, “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2017”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Demokratike për 12 zonat zgjedhore, së bashku me *deklaratat model 03*, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas *deklaratës model 03*, rezulton se gjinia femërore, si gjinia më pak e përfaqësuar në listën shumemërore qarku Kukës nuk ka asnjë kandidat femër. Në mbështetje të nenit 164, pika 2 (fjalë e fundit) duke qenë se lista nuk ka kandidatë të gjinisë femërore, KQZ-ja nuk mund të zbatojë sanksionin plotësues.

Në bazë të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Kukës, të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati për deputet me numër rendor 3 (tre), z. Alban Jonuz Zeneli.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Z. Alban Jonuz Zeneli, referuar ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 11.3.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2116.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të z. Alban Jonuz Zeneli, rezulton se: ka deklaruar dënime penale:

- Vendimi nr. 42, datë 20.8.1992, dënuar me 6 (gjashtë) muaj burgim, për veprën penale të parashikuar në nenin 81 të Kodit Penal, “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, dënuar me datë 7.7.1996, me 30.000 (tridhjetë mijë) lekë gjobë për veprën penale “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, të parashikuar nga nenet 236 dhe 274 të Kodit Penal.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1382 prot., datë 11.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 1381 prot., datë 11.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Kukës, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Alban Jonuz Zeneli, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të



Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. 1381 prot., datë 11.3.2019 zyra e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Kukës, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Alban Jonuz Zeneli.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Referuar germës “ç”, të pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen me dashje të një krimi kur janë dënuar me jo më pak se 6 (gjashtë) muaj burgim.

Ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë të cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar.

Sipas nenit 4 të ligjit të sipërcituar:

.....

4. Për personat që parashikohen nga shkronja “ç”, e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Z. Alban Jonuz Zeneli për veprën penale, “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1, i Kodit Penal, për të cilën kandidati është dënuar 6 (gjashtë) muaj burg është rehabilituar sipas nenit 69/“b” të Kodit Penal. Në këtë rast kjo e dhënë nuk përbën shkak sipas germës “ç”, pika 1, neni 2 i ligjit nr. 138/2015, për shpalljen e pavlefshmërisë së mandatit dhe ndërprerjen e mandatit, pasi ka përfunduar periudha e ndalimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit (të dhënave në formularin e vetëdeklarimit dhe vërtetimit të gjendjes gjyqësore) sipas germës “ç”, pika 1, neni 2, pika 4, neni 4, i ligjit nr. 138/2015, rrethanat e paraqitura nga z. Alban Jonuz Zeneli nuk

përfshihet në kushtet e ndalimeve për kandidim dhe për t’u zgjedhur në funksionin e deputetit.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore qarku Kukës, i renditur me numër rendor 3 (tre), z. Alban Jonuz Zeneli.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Kukës, z. Alban Jonuz Zeneli.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETARI
Klement Zguri

VENDIM Nr. 62, datë 12.3.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE, QARKU KORÇË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 12.3.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri	kryetar;
Denar Biba	zv.kryetar;
Bledar Skënderi	anëtar;
Edlira Jorgaqi	anëtare;
Rezarta Bitri	anëtare;

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënie e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, qarku



Korçë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, z. Ervin Bujar Salianji.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, neni 175 pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 715/2 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit z. Genci Gjonçaj njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetëve të zonës zgjedhore, qarku Korçë, të subjektit politik Partia Demokratike.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Demokratike për zonën zgjedhore qarku Korçë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 qershor 2017, ka fituar 4 (katër) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Korçë, janë numri rendor 1 (një) znj. Valentina Pandi Duka, me numër rendor 2 (dy) z. Ervin Bujar Salianji, me numër rendor 3 (tre) z. Hekuran Bujar Hoxhalli, me numër rendor 4 (katër) z. Klevis Fahri Balliu.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike, qarku Korçë, nuk i plotëson të

gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur tridhjetë për qind të listës shumemërore nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017 vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 12.000.000 (dymbëdhjetë) milionë lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore qarku Korçë duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, me vendimin nr. 338, datë 30.5.2017 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2017”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Demokratike për 12 zonat zgjedhore, së bashku me *deklaratat model 03*, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas *deklaratës model 03*, rezulton se gjinia femërore, si gjinia më pak e përfaqësuar në listën shumemërore qarku Korçë ka shteruar. Në mbështetje të nenit 164, pika 2 (fjalë e fundit), duke qenë se lista e gjinisë femërore ka shteruar, KQZ-ja nuk mund ta zbatojë sanksionin plotësues.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit vijues të listës shumemërore të Partisë Demokratike, të zonës zgjedhore qarku Korçë.

Sipas listës shumemërore të Partisë Demokratike për qarkun Korçë, kandidati vijues është kandidati i cili renditet me numër rendor 6 (gjashtë) z. Ligoraq Jorgji Karamelo.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 583 prot., datë 27.2.2019, z. Ligoraq Jorgji Karamelo, është njoftuar për



dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, njoftuar nga Posta Shqiptare më datë 5.3.2019.

Z. Ligoraq Jorgji Karamelo, referuar ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 5.3.2019 formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2112.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Ligoraq Jorgji Karamelo, rezulton se nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1299 prot., datë 5.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 1298 prot., datë 5.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Korçë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Ligoraq Jorgji Karamelo.

KQZ-ja, gjithashtu, ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. V-692/1 prot., datë 7.3.2019, zyra e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Korçë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Ligoraq Jorgji Karamelo, sipas së cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Ligoraq Jorgji Karamelo, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, duke qenë se lista e gjinisë femërore ka shteruar, mandati i ndërprerë i përket kandidatit vijues të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike në zonën zgjedhore qarku Korçë, i renditur me numër rendor 6 (gjashtë), z. Ligoraq Jorgji Karamelo.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, nenin 164, nenin 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Korçë, z. Ligoraq Jorgji Karamelo.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETARI
Klement Zguri

VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendim nr. 9697, datë 23.11.2018, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Vahit Bardhi, i datëlindjes 27.7.1959.

KËRKESË

Shtetasi Idriz Kovaçi, i datëlindjes 2.2.1957, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të vdekur të shtetases Edlira Kovaçi, e datëlindjes 5.6.1993.

KËRKUES
Idriz Kovaçi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 168 lekë